



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2020:054196

Datë: 29.07.2020

Numri i dokumentit: 01044621

C.nr.136/20

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË -Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil- më gjyqtarin Prenk Palushi, dhe asistentën administrative Violeta Lecaj-Lulaj duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditësit: P. B. S, nga Klina Rr. “L. P.” pn, kundër të paditurve : S. M. S, nga Klina Rr “V. G e K.Z” pn, dhe P. P. M. S, nga Klina Rr. “J.G”pn. baza juridike: vërtetim pronësie, vlera e kontestit 3.100 euro , pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me dt.14.07.2020, në të cilën prezantuan paditësi si dhe të paditurit , me dt.29.07.2020 bijë këtë:

A K T G J Y K I M
në bazë të pohimit

- I. APROVOHET SI E BAZUAR-**Kërkesëpadia e paditësit : P. B. S, nga Klina Rr. “L. P” pn.
- I. VËRTETOHET- se:** P. B. S, nga Klina Rr. “L. P”pn. Është pronar i paluajtëshmërisë të shtrirë në parcelat kadastrale: nr. P-..... ZK. D... vendi i quajtur f... e Klinës -m... në sipërfaqe prej m², e cila paluajtëshmeri ne certifikatën e pronës nr. është e evidentuar ne bashkëpronësi në pjese ideale me nga ½ në mes të bashkëpronareve M. P. S dhe B. P. S .
- II. OBLIGOHEN** – të paditurit që të drejtën e pronësisë në paluajtëshmerin e theksuar si më lartë të ja njoh dhe pranoj palës paditëse, në atë mënyrë që i njëjti të përmbahet lidhur më regjistrimin e të drejtës se pronësisë së paditësit në regjistrin e të drejtave për pronë të paluajtshme të Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër e Pronësi K.Klinë, dhe këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përbarimit ligjor.
- III.** Shpenzimet procedurale i bartë pala paditëse.

A r s y e t i m

Paditësi: P. B. S, nga Klina Rr. “L. P” pn, në shqyrtimin kryesor si dhe në fjalën përfundimtare duke qëndruar pranë padisë dhe kërkesës se saj thekson se paluajtëshmeria lëndore e regjistruar si në parcelën kadastrale P...në vendin e quajtur f... e Klinës K.Klinë në sipërfaqe prej ...m², në regjistrin e të drejtave për pronë të paluajtshme të drejtorisë përkatëse është e regjistruar në pjese ideale me nga ½ në emër të bashkëpronarëve M. P. S, dhe B. P. S, . B... është babai im, ndërkaq M... është axha im e cila bashkëpronësi ka lindur ,përkatesisht është krijuar qysh në rastin e shpërndarjes të bashkësisë familjare të dy bashkëpronarëve në vitin, po në këtë vit bashkëpronaret e sipërtheksuar B. S, dhe M. S, janë dakorduar plotësisht duke shprehur pëlqimin dhe vullnetin e tyre të plotë që në suaza të ndarjes së bashkësisë së gjërë familjare parcela kadastrale në tërësi e sipër theksuar e cila është objekt i kërkesëpadisë të shfrytëzohet përkatësisht të kalon në posedim dhe shfrytëzim faktik në tërësi në bashkëpronarin B. P. S, andaj që nga ajo kohë e deri me sot B. P. S, paluajtëshmerine e sipër theksuar e ka në posedim

dhe shfrytëzim pa u penguar nga askush, më kulturë livadh ,mirëpo deri me tani të njëjtën për shkaqe të ndryshme nuk e ka regjistruar tërësisht në emër të vetin në regjistrin përkatës të drejtorisë përkatëse përfundon deklarin e tij duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar.

Të paditurit S. M. S, dhe P. M. S, njëzëri deklaruan në seancën e shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare : së nuk e kontestojnë padinë dhe kërkesën e saj, si dhe deklarin e sipër theksuar të paditësit ,me që është vërtetët së ne të paditurit jemi të bijtë e M. P. S, ne emër të të cilit evidentohet paluajtëshmeria lëndore në bashkëpronësi me ½ në mes të babai tonë dhe axhës B. P. S, ,e cila paluajtëshmeri lëndore ne sipërfaqe prejm2 qe nga viti e këndej viti kur është shkëputur bashkësia e gjere familjare ne mes të dy vëllezërve M. S, dhe B. S, nga të njëjtit është vendosur duke u dakorduar plotësisht qe kjo parcele kadastrale në tërësi ti takoj B.S, andaj edhe e njëjta që nga ajo kohë e deri me sot ka kaluar në posedimë dhe shfrytëzim të lirë të axha jonë B... edhe pse në certifikatën e pronës evidentohët në bashkëpronësi në pjesë ideale me nga ½. Andaj shprehim pëlqimin dhe vullnetin tonë të lirë pa kurrfarë presioni nga jashtë që paluajtëshmeria lëndore e theksuar si më lartë në tërësi të regjistrohet në certifikatën e pronës ne emër të paditësit P. B. S, më që e njëjta është ne posedim dhe shfrytëzim siç u tha edhe më lartë nga paditësi, andaj kërkesëpadinë si dhe gjendjen faktike ne të cilën mbështetet e njëjta e pranojnë në tërësi më që nuk ka asgjë kontestuese lidhur me të njëjtën .

Me pohimin e fakteve nuk është e nevojshme gjykata ti provoj te njëjtat ndërkaq me pranimin e kërkesëpadisë pushon nevoja e zbatimit te se drejtës materiale në gjendjen e konstatuar faktike ,mirëpo gjykata zbaton procedurën e provave për te vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, gjatë të cilës lexon prova materiale si në vijim: certifikata e vdekjes V..... nr.. i ref.... RV/... ,nr. rend ... e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civil e në Klinë me dt....., certifikata e vdekjes nr ser V.... nr. i ref/.... RV/... nr. rend ... Dt., certifikata e pronës e Drejtorisë për Kadaster Gjeodezi e Pronësi Klinë nr..... e dt....., certifikata e pronës e Drejtorisë për Gjeodezi Kadaster e Pronësi nr..... e dt....., ekstrakti i lindjës me nr. E në emër të P. S, i lindur me dt.....-..... në Klinë nga prindërit B. dhe T. S, ekstrakti i lindjës me nr. E ne emër të P. S. i lindur me dt..... në Klinë nga prindërit M. dhe F. S. dhe ekstrakti i lindjes me nr.E S. S. i lindur me dt..... në Klinë nga prindërit M. dhe F. S.

Nga provat materiale te theksuara si me lartë gjykata vërtetëtoj legjitimitetin real aktiv të paditësit, me që paluajtëshmeria lëndore në certifikatën e pronës ishte e regjistruar në emër të prindit të tij B. P. S, në bashkëpronësi të ½ në pjesë ideale, si dhe legjitimitetin real pasiv të paditurve, me që paluajtëshmeria ishte e regjistruar në bashkëpronësi në emër M. P. S, të prindit të tyre me ½ në pjese ideale.

Në bazë të provave të sipërtheksuara si dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, ,gykata vije deri të përfundimi se paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtëshmerinë lëndore të theksuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi , në bazë të dispozitës ligjore të nenit 20 të ligjit mbi marrëdhënjet themelore juridike pronësore , në të cilën dispozitë ligjore përcaktohet: ‘e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit , në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi ,e drejta pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj. Sipas vetë ligjit e drejta e pronësisë fitohet me krijimin e sendit te ri , më bashkim,më përzierje , më ndërtim në tokën e huaj, më ndarjën e fryteve , më parashkrim fitues,më fitim të pronësisë nga jopronari, më okupim dhe në raste të tjera të caktuara më ligj’.

Dispozitat ligjore të nenit 33 të po të njëjtit ligj përcaktojnë:’’ në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë në paluajtëshmeri fitohet më regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar më ligj’’.

Gjykata vije deri të përfundimi se kërkesëpadia e paditësit dhe të paditurve –është e bazuar ,pasi që palët ndërgjyqëse kanë vërtetuar faktin relevant duke mos e kontestuar asnjërën se në vitin të njëjtit përkatësisht paraardhësit e tyre i kanë rregulluar raportet juridiko pronësore në mes

tyre ,duke bërë ndarjën fizike me marrëveshje të pasurisë që u ka takuar nga paraardhësit juridik ,dhe se çdo njëri nga ata e ka në posedim dhe e shfrytëzon pjesën e vet fizike që i ka takua në bazë të ndarjës fizike verbale, që derivon nga baza e trashëgimisë.

Konform dispozitave ligjore të nenit 3.3 gjykata vijë deri të përfundimi se palët ndërgjyqëse në këtë qeshtje juridiko civile kanë të drejte të disponojnë lirisht me kërkesat e tyre, si dhe të ndërmarrin veprime disponibile në këte çeshtje juridiko civile më që të njëjtat nuk janë në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat ligjore dhe rregullat e moralit publik, andaj në kuptim të dispozitave ligjore të lartcekura si dhe konform nenit 148 të LPK-së gjykata bje aktgjykim në bazë të pohimit ,më që të paditurit e pohojnë në tërësi kërkesëpadinë.

Konform dispozitave ligjore të nenit 148 LPK-së gjykata në këtë qeshtje juridiko civile merr aktgjykim në bazë të pohimit, me që plotësohen të gjitha kushtet ligjore për marrjen e të njëjtit.

Konform dispozitave ligjore të nenit 452 të LPK-së gjykata vendosi lidhur me pagesën e shpenzimeve procedurale.

Nga arsyet e theksuara më lartë konform dispozitave ligjore të nenit 3.3 dhe 148 dhe 142 i LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË KLINË
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.136/20, me dt. 29.07.2020

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ngritët ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

G j y q t a r i
Prenk Palushi

Numri i lëndës: 2020:054196
Datë: 29.07.2020
Numri i dokumentit: 01044621